

29 gusht 2019

Zyra Rajonale e UN Women për Evropën dhe Azinë Qëndrore

Thirrje për Propozime: Përmbledhje Rajonale Tregimesh – Histori që Ndryshojnë Jetë

****DATA E APLIKIMIT - 30 SHTATOR 2019****

Konteksti

Gjatë 2019-2020, Zyra Rajonale e UN Women për Evropën dhe Azinë Qëndrore (ECARO) shënon 25 vjetorin e Konferencës së Katërt Botërore për Gratë dhe miratimin e Deklaratës së Pekinit dhe Platformës për Veprim.

Me këtë rast, Zyra Rajonale e UN Women për Evropën dhe Azinë Qëndrore po përgatit një përmbledhje rajonale tregimesh të frymëzuara nga figura femërore reale ose imagjinare nga Evropa dhe Azia Qendrore, të cilat përfaqësojnë një pjesë të rëndësishme të trashëgimisë së vendit të tyre: rrëfime historike për të frymëzuar dhe nxjerrë mësimet nga e kaluara dhe histori fiktive për të zgjeruar potencialin imagjinitiv të asaj që mund të jetë e mundur. Koleksioni synon të promovojë gra dhe vajza të forta dhe të frymëzojë vajzat të realizojnë potencialin e tyre dhe të kontribuojnë në zhvillimin dhe mirëqenien e shoqërive të tyre përkatëse. Historitë gjithashtu do t'u japin mundësi vajzave të përparojnë duke zgjeruar horizontin e pritshmërive të tyre, në të njëjtën kohë edhe djemve do iu japin një sërë shembujsh grash të forta, në mënyrë që edhe ata të imagjinojnë një botë me barazi më të madhe gjinore.

Cfarë është Risi dhe pse ne kemi Nevojë për ju

Zyra Rajonale e UN Women për Evropën dhe Azinë Qëndrore kërkon aplikime për një përmbledhje rrëfimesh që paraqesin histori frymëzuese për gra dhe vajza duke synuar një audiencë të lexuesve të rinj. Propozimet do të ri-nxjerrin në dritë zërat e heshtur dhe figurat e grave nga historia dhe fantazia në Evropë dhe Azinë Qendrore. Këto histori do të inkurajojnë lexuesit e rinj të reflektojnë mbi barazinë gjinore dhe të bëhen agentë të ndryshimit duke paraqitur histori suksesi të grave dhe vajzave dhe kontributet e tyre pozitive në komunitetet e tyre dhe në shoqëri.

Ne ftojmë dhe inkurajojmë një gamë të gjerë kontribuesish/esh – autorë/e dhe mësues/e, historian/e, gazetarë/e, fëmijë të vegjël, anëtarë/e nga shoqëria civile dhe grupe rinore, nëna dhe baballarë - të gjithë që kanë një histori për të treguar mbi gra dhe vajza që kanë patur një ndikim domethënës në shoqëri.

Shpresojmë që këto histori vajzash dhe grash, të cilat kanë sjellë ndryshim, të shërbejnë për të treguar mënyrat e shumta me të cilat gratë dhe vajzat e sotme, burrat dhe djemtë mund të përmbysin normat dhe paragjykimet gjinore, dhe të krijojnë shoqëri më të barabarta dhe të fuqizuara për brezat e tanishëm dhe të ardhshëm.

Përmbledhja e tregimeve do të paraqitet në një seri platformash dhe aktiviteteve rajonale dhe globale, në të gjithë Evropën dhe rajonin e Azisë Qendrore gjatë vitit 2020, si pjesë e 25-vjetorit të Deklaratës së Pekinit dhe Platformës për Veprim.

Procesi i pranimit dhe përzgjedhjes

1. Aplikimi duhet të jenë në formën e një abstrakti/ përmbledhje, 200 fjalë maksimumi.
2. Aplikimet duhet të frymëzohen nga figura grash dhe vajzash historike të harruara apo imagjinare nga Evropa dhe Azia Qendrore
3. Aplikimet duhet të përfshijnë një Letër Përmbledhëse që paraqet personazhin dhe arsyen e përzgjedhjes
4. Fryma e përgjithshme duhet të jetë "shpresëdhënëse", për mundësitë e së ardhmes dhe t'u drejtohet lexuesve të rinj
5. Aplikimet duhet të jenë frymëzuese, por dhe realiste: domethënë, ato nuk duhet të mohojnë ekzistencën e pabarazisë gjinore, edhe kur paraqesin mundësi për t'i rezistuar ndryshimeve dhe për të qenë mbizotëruese në shoqëri
6. Të gjitha aplikimet do të rishikohen nga një 'Komitet Shqyrtues'
7. Faza e parë e procesit të përzgjedhjes do të jetë një rishikim i abstrakteve /përmbledhjeve
8. Të përzgjedhurit për të kontribuar bazuar në abstraktet / përmbledhjet e tyre, do të ftohen të kontribuojnë me dorëzimin e plotë
9. Pas zgjedhjes përfundimtare, një autor do të punojë me kontribuesit për të përfunduar draftet përfundimtare

Kushtet e aplikimeve

- E hapur për të gjithë - të gjitha moshat, gjinitë dhe profesionet
- Preferohet që gjuha e aplikimeve të jetë në anglisht, sidoqoftë aplikimet mund të bëhen dhe në gjuhët e mëposhtme të rajonit: Turqisht, Rusisht, Frëngjisht, Spanjisht, Shqip dhe Serbisht
- Aplikimi mund të jetë një narrativë tradicionale - d.m.th, një histori që qarkullon në komunitet, ose mund të jetë një narrativë e krijuar së fundmi
- Narrativat duhet të jenë të përqëndruara në gratë dhe vajzat - gra dhe vajza reale ose imagjinare, të njohura ose të harruara që kanë bërë një ndryshim
- Plagjiatura dhe shkelja e të drejtës së autorit në çdo fazë të procesit do të çojnë në skualifikim të menjëhershëm
- Vendimet e Komisionit Shqyrtues janë përfundimtare në çdo fazë

Afatet e aplikimeve

1. Abstrakt / përmbledhje (200 fjalë maksimumi) dhe një letër përmbledhëse deri të Hënën, më 30 shtator 2019
2. Njoftimi i përzgjedhjes deri të Martën, 15 Tetor 2019
3. Dorëzimi i plotë i draftit të parë deri të Premten në 15 Nëntor 2019

Ju lutemi paraqisni abstraktet/ përmbledhjet tuaja në: ECA.programme@unwomen.org dhe në titullin e subjektit specifikoni qartë "Fairy Tales".